



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:008334

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05412181

C.nr.350/2023

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, si civile në përbërje nga gjyqtari Hajrullah Aruqi, në kontestin e paditësit N.M.nga fshati..., komuna Skenderaj, që e përfaqëson me autorizim A.F. avokat në Prishtina, kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria Komunale për Arsim, që e përfaqëson zyrtari ligjor E.Ç., për anulim të vendimit, emërim në pozitë të mësimdhënësit dhe kompensim të pagave, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor të dt. 14.12.2023 me pjesëmarrjen e palëve ndërgjyqese, më dt.29.12.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N.M.nga fshati..., komuna Skenderaj, me te cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi për emrimin e kandidatit nr.1045/19 i dt.03.09.2019 si i kundërligjshëm, ashtu që të detyrohet e paditura që paditësin të sistemoj në vendin e punës (mësimdhënës për lëndën mësimore Histori dhe Edukatë Qytetare) në SHFMU “Bashkim Sadiku” në fshatin Tushilë dhe t’i paguaj kompensimin e pagave dhe kompensimet tjera që do t’i realizonte paditësi nga dt.01.09.2019 deri me dt. 15.03.2021 në shumën e përgjithshme prej 16,149.51 euro (gjashtëmbëdhjetëmijë e njëqind e katërdhjetë e nëntë euro e pesëdhjetë e një cent) me kamatën ligjore në normën prej 8% nga dita e gjykimit si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 1,881 euro

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes padisë së ushtruar në gjykata ka kërkuar që të detyrohet e paditura që, paditësin ta kthej në vendin e mëparshëm të punës dhe t’i kompensoj pagat duke theksuar se ka aplikuar në konkursin e dt.13.07.2019 të shpallur nga e paditura për plotësimin e vendit të punës për lëndën mësimore Histori dhe Edukatë Qytetare, pas testimit me shkrim dhe me gojë të mbajtur nuk është pranuar paditësi me arsyetimin se, nuk i plotëson kushtin e përcaktuar me Udhëzimin

Administrativ nr.10/2008 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, edhe përkundër faktit se paditësi posedon kualifikim përkatës për pozitën të cilën ka aplikuar dhe ka kualifikim edhe master dhe studimet themelore të sistemit katër (4) vjeçar “Bachelor i Historisë dhe Edukatës Qytetare”.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dt. 06.07.2020 e kundërshtoj kërkesë padinë në tërësi si të pa bazuar më arsyetimin se nuk ka bazë ligjore nga se DKA me rastin e përzgjedhjes se kandidatit në konkursin e dt. 13.07.2019 nga komisioni përkatës profesional është zgjidhur kandidati që i ka plotësuar më mirë kriteret e përcaktuar me konkurs i cili ka të përfunduar fakultetin e Historisë në sistemin katër (4) vjeçar dhe përvojën e punës gjashtë muaj në raport me paditësin, po ashtu dhe gjatë intervistimit me gojë dhe provimit me shkrim ka treguar rezultate më të mira se paditësi dhe kandidati M.B. ka marrë gjithsej 158 pikë ndërsa paditësi ka arritur t'i marrë 132 pikë, prandaj për këto arsye komisioni ka vendosur që në vendin e punës të e përzgjedh kandidatin M.B. i cili ka 26 pikë më shumë.

Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Skenderaj ka vendosur në këtë çështje juridike me Aktgjykimin C.nr.463/2019 të dt.10.05.2021 duke e aprovuar kërkespadinë e paditësit si të bazuar.

E paditura ka ushtruar ankesë me dt.25.06.2021 kundër Aktgjykimit C.nr.463/2019 të dt.10.05.2021 për Gjykatën e Apelit në Prishtinë me propozim që, të aprovohet ankesa e të paditurës dhe të priset Aktgjykimi C.nr.463/2019 të dt.10.05.2021 i Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Skenderaj dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktvendimin Ac.nr.10293/2021 të dt.10.08.2023 e ka aprovuar ankesën e palës së paditur, duke e prishur Aktgjykimin C.nr.463/2019 të dt.10.05.2021 të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Skenderaj dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje, ku Gjykata e shkallës së parë është udhëzuar që të veprojnë konform vërejtjeve të dhëna nga Gjykata e Apelit.

Përfaqësuesi i palës paditëse në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.08.11.2023 deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkespadiës së paditësit dhe deklarimeve në seancat e mëparshme, ku Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac.nr.10293/21 konsiderojmë se nuk e trajtuar në mënyrë meritore çështjen e paditësit dhe vendimin e Gjykatës së shkallës së parë duke mos ia njohur paditësit studimet master të përfunduara të dëshmuara me certifikatën nr.04/868, si dhe i njëjti i ka plotësuar kushtet edhe në bazë të UA nr.10/2018 dhe se kandidati i përzgjedhur nuk e ka qenë i profilit adekuat. Ligjit për Arsimin Parauniversitar neni 35 të cilit i referohet edhe Gjykata e Apelit përcakton çartë përzgjedhjen e kandidatëve në rastin konkret paditësit dhe se me asnjë ligj nuk specifikohet se certifikata dhe përfundimi i studimeve master nuk e zëvendëson diplomën. Më tutje shtoi se meqenëse me ekspertizë financiare është përcaktuar periudha kohore e kompensimit të pagave për paditësin nga dt.01.09.2019 deri me dt.15.03.2021 i propozon gjykatës që të nxjerrret edhe ekspertiza financiare për periudhën kohore nga dt.15.03.2021 deri me përpilimin e ekspertizës.

Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.14.12.2023 u deklarua se nuk e kundërshton eksperizen e punuar nga eksperti R.S., ku dhe bëri precizimin e padisë dhe kërkespadiës ku deklaroi se, për pagat për periudhën për vitet dt.01.09.2019 e deri me dt.15.11.2023 kërkoj shumën prej 14,627.28 euro, kamatën ligjore për vones në pagën bazë për periudhën dt.16.03.2021 deri me d.15.11.2023 shumën prej 1,522.23 euro, kontributin pensionale shumën prej 1,614.98 euro, tatimin në pagë shumën prej 811.31 euro, kontributin në SBASHK shumën prej 72.68 euro, e gjithsej pagat bruto për periudhën kontestuese në shumën prej 16,149.51 euro. I kërkoj shpenzimet e procedurës për përpilimin e padisë shumën prej 208 euro, për përfaqësime në 5 seanca gjyqësore shumën prej 1,352 euro, për taks gjyqësore shumën prej 21 euro, për dy ekspertiza financiare shumën prej 300 euro, e në shumën e përgjithshme prej 1,881 euro.

Ndërsa në fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim ka deklarua se, mbetet pranë padisë dhe deklarimeve të thëna si në seancat e kaluara dhe pas nxjerrjes së provave u vërtetua edhe baza juridike e kërkespadiës së paditësit dhe pretendimet se pala e paditur në procedurën e konkursit për plotësimin e vendit të punës për mësimdhënës të lëndës Histori dhe Edukata Qytetare në kundërshtim me UA 10/2018 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm ka përzgjedhur kandidatin M.B., i cili nuk ka poseduar kualifikimin përkatës për këtë pozitë. Poashtu e paditurame përzgjedhjen e kandidatit ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 35 par.5 të Ligjir nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar, sepse nuk e ka marrë për bazë si kriter parësor siç është arsimimi adekuat i paditësit, por ka marrë si përparësi të kandidati i pranuar përvojën e punës prej 6 muajsh si mësimdhënës i ciklit klasor, e cila përvojë nuk është në lëndën mësimore profesionale, andaj i propozoj gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkespadinë e paditësit si të bazuar dhe të obligohet e paditura që ta anuloi vendimin për emrimin e kandidatit M.B. në pozitën Mësimdhënës në lëndën Histori dhe Edukatë Qytetare në bazë të vendimit nr.1045/19 të dt.03.09.2019, si dhe i kërkoj shpenzimet siç janë specifikuar në seancën e dt.14.12.2023.

Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e shqyrtimit kryesor fillimisht u deklarua e kundërshtojnë precizimin e ekspertizës me arsyetim se, konsiderojnë që i mungon baza juridike e kërkespadiës, prandaj mbi këtë bazë nuk kanë vlerë as ekspertiza financiare e as precizimi i padisë. Më tutje në fjalën përfundimtare u deklarua se qëndrojnë pranë përgjegjës në padi, pran çdo deklarami të dhëne si në seancat e kaluara, pasi që kandidati i pranuar M.B. ka diplomuar në vitin 2008, ku në atë periudhë kohore fakulteti - katedra e historisë nuk e ka përfshi pjesën Edukatë Qytetare, kjo ka ndodh me vonë kur paditësi pas disa viteve me vonë ka diplomuar. Paditësi për pozitën e mësimdhënësit ka aplikuar me dokumentin diplomë Fakulteti Bachelor dhe se është vërtetuar nuk ka pas certifikatë diplomë të masterit, e as diplomën e masterit, ndërsa certifikata e notave që dëshmon provimet e dhëna në master nuk e mbulon as certifikatën dhe as diplomën e masterit. Sa i përket përvojës së punës kundërkandidati M.B., ka pas përvojë punë kur është pranuar në pozitën e mësimdhënësit, ndërsa paditësi nuk ka pasur përvojë punë në mësimdhënie, këtë shumë qart e ka sqaruar edhe Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit AC.nr.10293/2021, poashtu M.B. ka arritur poentim më të lart si në testin me shkrim ashtu edhe në intervistën me gojë dhe për kundër asaj që ka pas përvojë punë si mësimdhënës, kundërkandidati ka pasur 158 pikë, ndërsa paditësi ka arritur 132 pikë në total, ku paditësi dhe kundërkandidati të dy kanë kualifikime në degën e Historisë, por kundërkandidati ka përvojë punë dhe poentim në test me shkrim dhe interviste me gojë, gjë të cilën këto avantazhe kanë bërë që të zgjedhet në këtë pozitë dhe mos të përzgjidhet paditësi, andaj në bazë të lartcekurave gjykatës i propozoj që padinë dhe kërkespadiinë ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata me qëllim të konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në çështjen konkrete juridike në kuptim të nenit 7 dhe 8 të LPK-së i nxori dhe i administroj të gjitha provat e propozuara nga ndërgjyqësit të evidentuara në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor me dt. 28.04.2021, plotësim ekspertizën financiare e dt.21.11.2023, Akvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.10293/2021 të dt.10.03.2023, një nga një dhe të gjitha së bashku duke i krahasuar njërën me tjetrën nga të cilat rezultoi se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

E paditura Drejtoria Komunale për Arsim me dt.13.07.2019 sipas Vendimit nr. 925/2019 në përputhje me Ligjin e Punës dhe aktet tjera nënligjore e ka publikuar konkursin për plotësimin e vendeve të lira të punës në pozita te ndryshme në Shkollat Filllore të Mesme të Ulët në Komunën e Skenderajt. Në pikën 4 të këtij konkursi ishte publikuar një vend i lirë pune për 12 orë mësimore për lëndën Histori dhe Edukatë Qytetare në SHFMU... në fshatin... Prej formularit për aplikim i DKA në Skenderaj dt. 15.07.2019 nr. 07-111/01-0043799/19 konstatohet se paditësi me datën e lartpërmendur e ka shpreh interesimin përmes aplikimit për mësimdhënës për lëndën mësimore Histori – Edukatë Qytetare dhe në formular ka paraqit të dhënat personale dhe dëshmitë për përgatitjen profesionale, në faqen e fundit të formularit dëshmohet se paditësi i ka bashkëngjitur dokumentacionin: kopja e vërtetuar e diplomës, certifikatën e trajnimeve dhe certifikatën e notave për kualifikimin master.

Prej diplomës nr.1165 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” më dt.19.06.2013 konstatohet se paditësi N.M. i lindur me dt... në fshatin... është regjistruar në vitin akademik 2007/2008 në Fakultetin e Edukimit Qendra në Prishtinë i ka mbaruar studimet me dt.10.05.2012 në programin mësimor Histori – Edukatë Qytetare dhe ka marrë titullin Bachelor i Histori-Edukatë Qytetare, ky kualifikim sipas kornizës kombëtare të kualifikimit: 6 gjithsej ka 240 kredi.

Prej vërtetimi të lëshuar nga Fakulteti i Edukimit Qendra në Prishtinë nr. reference 04/2714 dt.02.09.2019 konstatohet se paditësi kishte regjistruar semestrin e dytë master në vitin 2018/19.

Nga çertifikata nr. reference 04/868 e lëshuar nga Universiteti “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit dt.18.03.2019 konstatohet se paditësi i regjistruar me nr. te dosjes 141411210048 me dt. 25.06.2015 i ka përfunduar provimet me dt.15.09.2018 me notë mesatare 6.44 dhe totalin e kredive e ka 52, andaj gjykata edhe sipas rekomandimeve të Gjykatë së Apelit, e analizoi me vemendje certifikatën e notave, ku konstatohet se certifikata e përfundimit të provimeve për Master e askund nuk konstaton se paditësi me përfundimin e provimeve të këtij niveli studimor e ka marrë titullin që pretendon (master). Meqenëse paditësi gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk provoi me diplomë se është i diplomuar në nivelin e studimeve Master, konform nenit 4 të Rregullores për Studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me nr. prot. 2/922 e datës 24.10.2019 ku shprehimisht është përcaktuar “*studimet master përfundojnë me përfundimin – mbrojtjen publike të punimit dhe studenti merr diplomën me 120 ECTS ose 60 ECTS, në varësi të programit të studimit*” prandaj gjykata në mungesë të kësaj prove konstatoi se paditësi nuk ka përfunduar studimet master.

Me nenin 35 par.1 i Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimimin Parauniversitar përcaktohet se “*Drejtoret dhe zëvendës drejtoret e institucioneve arsimore, mësimmhënësit, asistentet, dhe instruktoret zgjidhen përmes një konkursi publike në bazë të meritës personale pa asnjë lloje diskriminimi të drejt për drejt apo të tërthortë për arsye reale apo të supozuara që ka lidhje me gjininë, racën, gjendjen martesore, orientimin seksual përkatësisht etnik, nevojat e veçanta, pasurin, vendin e lindjes, pikëpamjet politike ose filozofike apo rrethanat e tjera*”, ndërsa në par. 5 të po këtij neni përcaktohet se “*Kur bëhet përzgjedhja midis një apo më shumë kandidatëve për një post menaxhues ose për mësimmhënës, merren për bazë kushtet, si janë: arsimimi i secilit kandidat, përvoja, kualifikimet për pozitë dhe nevojat që do të plotësojë ky emërim...*”, andaj gjykata konstaton se të dy kandidatët kanë të mbaruar studimet Bachelor.

Gjykata pas vlerësimit të gjitha fakteve dhe provave erdhi në përfundim se pretendimet e palës paditëse janë të pabazuara për faktin se kandidati i përzgjedhur për këtë vend të punës M.B., nga fshati... sipas Diplomës nr.1126 e lëshuar më dt. 12.06.2008 nga Univerziteti Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë, konstatohet se ka të mbaruar Fakultetin - Dega e Histories katër (4) vjeçar me dt. 30.04.2008, nga e ka marrë titullin Profesor i Histories. Paditësi dhe kandidati i përzgjedhur iu kanë nënshtruar provimit – testit dhe sipas vlerësimit të komisionit profesional në përbërje nga H.A., Sh.I. dhe R.I. ku paditësi është vlerësuar me 132 pikë, ndërsa kandidati që është përzgjedhur është vlerësuar më 158 pikë. Komision përveç këtij vlerësimi si përparësi të kandidatit të përzgjedhur ndaj paditësit e ka marrë edhe përvojën e tij të punës, i cili ka punuar në shkollën fillore... në fshatin... për 6 muaj, që dëshmohet me vërtetimin nr. protokollit 07 i dt. 24.02.2015 për periudhën nga dt. 01.09.2010 deri me dt. 28.02.2011 dhe mbi këtë bazë është, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Nga provat e administruara është vërtetuar se e paditura ka kërkuar plotësimin e vendit të punës përmes konkursit publik në përputhje me Ligjin e Punës 03/L-2012 përkatësisht dispozitat e nenit 8, ndërsa kushtet që është dashtë t'i plotësoj kandidati për tu pranuar janë të përshkruar decidivisht në nenin 5 paragrafi 12.2 ku bëhet fjalë për lëndën mësimore “Histori”, në paragrafin 12.2.1 është përcaktuar “niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ects)”, në paragrafin 12.2.2 është përcaktuar “sistemi katër vjeçar”, në paragrafin 12.2.3 parashifet “Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS), e në rastin konkret gjykata vërtetoi se paditësi edhe pse e ka pregaditjen adekuate profesionale të kërkuara me konkurs nr. 925/2019 i dt 13.07.2019 për lëndën mësimore “Histori - Edukat Qytetare”, kundërkandidati i përzgjedhur i ka përmbushur kriteret e përcaktuara në bazë të këtij konkursi, andaj nga këto fakte të vërtetuara gjykata erdhi në përfundim se e paditura nuk ka nxjerr vendim në kundërshtim me Ligjin e Punës pikërisht neni 5 par.3 dhe të dispozitave të nenit 35 par.5 të Ligjit nr.04/L-032 dhe Udhëzimit Administrativ 10/2018.

Në bazë të ekspertizës financiare të punuar nga eksperti R.S., i cili me dt.16.03.2021 ka dhen mendim dhe konstatim me shkrim si dhe sqarime në seancë me dt.28.04.2021 është konstatuar se paditësi ka paga të përealizuara për vitin 2019 në shumën prej 1,758.42, për vitin 2020 shumën prej 5,230.25, për vitin 2021 shumën prej 1,104.53 gjithsejtë shumën prej 8,093.2 euro, ndërsa në plotësimin e ekspertizës financiare të dt.16.03.2021 të hartuar me dt.15.11.2023 ka konstatua se nga periudha kohore dt.16.03.2021 deri me dt.15.11.2023 paditësi ka paga të përealizuara pas

llogaritjes së kamatës në pagën bazë paga bruto arrin shumën prej 16,149.51 euro, ndërsa paga neto pas ndalesave të kontributeve është 14,981.09 euro.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar si rezultat i provave të administruara gjykata erdhi në përfundim se paditësi nuk arriti ta provojë fakte dhe prova bazueshmërinë e kërkesëpadisë prandaj gjykata nuk gjeti arsye ligjore për ti ofruar mbrojtje gjyqësore

Gjykata i vlerësoj të gjitha pretendimet e palës së paditëse, por këto pretendime krahasuar me provat e vërtetuar gjatë shqyrtimit kryesor rezultojnë të mos jenë të bazuara, andaj koto pretendime nuk janë me ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është i bazuar në dispozitat e nenit 450 të LPK-së.

Me sa u tha më lartë konform dispozitave materiale të përmendura më lartë dhe dispozitave të nenit 143 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM.
C.nr.350/2023, me dt.29.12.2023**

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, nëpërmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.